



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.418/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti kryesues, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik, Partia Kosovskih Srba (PKS), me seli në Leposaviq paraqitur kundër Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, me seli në Graçanicë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.02.2025, mori këtë,

### V E N D I M

Hedhen të pas afatshme ankesat e Subjektit Politik, Partia Kosovskih Srba (PKS), me seli në Leposaviç, Anr.418/2025 dhe Anr.425/2025, të datës 07.02.2025, të paraqitura kundër Subjektit Politik, Za Slobodu Pravdu Opstanak, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

### A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 07.02.2025 PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.418/2025 dhe Anr.425/2025, nga Subjekti Politik, Partia Kosovskih Srba (PKS), me seli në Leposaviç.

Në ankesën Anr.418/2025, pretendohet se aktivistët e Subjektit Politik, Za Slobodu Pravdu Opstanak, vendosën postera në hyrje të shkollës fillore “Stana Baçanin” më pak se 100 metra larg, e cila është edhe vendvotimi në qytetin e Leshakut në lokacionin e rrugës “Braçe Matoviqa”, e cila është në kundërshtim me Rregulloren zgjedhore të miratuara nga KQZ.

Në ankesën Anr.425/2025, pretendohet se aktivistët e subjektit politik, Za Slobodu Pravdu Opstanak, shkatërruan dhe ngjitën postera mbi postera të Partia Kosovski Srba (PKS), në qytetin e Leshakut në lokacionin rruga “Braçe Matovic”, e cila është në kundërshtim me Rregulloren zgjedhore të miratuara nga KQZ.

Në mbështetje të këtij pretendimi, kanë bashkangjitur fotografi nga vendi i ngjarjes të realizuar nga aktivistët e Partia, Kosovskih Srba (PKS), më datë 01.02.2025, ku shihen posterat e PKS-së, të cilët më pas janë asgjësuar në kundërshtim me Rregulloren Zgjedhore. Si provë ka bashkangjitur fotografi nga vendi i ngjarjes të realizuar nga aktivistët e Subjektit Politik PKS më 01.02.2025.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 07.02.2025, nga Subjekti Politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, pretendohet se vendosja e postërve në rrugën “Braçe Matoviq” në Leshak është objekt publik dhe i përket Komunës së Leposaviqit, e cili i ka lejuar të vendosin materiale të tjera propagandistike. Më tej në përgjigje pretendohet se edhe Subjekti Politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, kanë bërë ankesa lidhur me posterat e dëmtuar, nga 500 postera që kanë vendosur në Komunën e Leposaviqit dhe në Leshak, tani kanë mbetur vetëm 20 postera, bazuar në vëzhgimet në terren, pothuajse të gjithë posterat janë hequr dhe keqpërdorur. Sipas përgjigjes në ankesë të Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, ata janë të vetëdijshëm se vendosja e posterave brenda dhe mbi ndërtesa dhe në vende (objekte publike) nuk lejohet, cenon Kodin Zgjedhor.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.418/2025 dhe Anr.425/2025, të paraqitura me datë 07.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.418/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, vëren se ankesat janë të pas afatshme.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesave ka gjetur se ankesat e parashtruara nga Subjekti Politik Partia, Kosovskih Srba (PKS), me seli në Leposaviç, paraqitur kundër Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, të datës 07.02.2025, janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nën paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor”*

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, rezulton se parashtruesi i ankesave ka dorëzuar ankesat në PZAP, më datë 07.02.2025, në të cilën ka pretenduar se me datë 01.02.2025 aktivist të Subjektit Politik Za Slobodu Pravdu Opstanak, me seli Graçanicë, kanë vendosur postera në hyrje të shkollës fillore “Stana Baçanin” dhe në qytetin e Leshakut në

lokacionin rruga “Braçe Matoviq, të njëjtit dëmtuan dhe vendosën postera mbi postera të Subjektit Politik Partia Kosovskih Srba (PKS).

Veprime të cilat janë në kundërshtim me nenin 34. Paragrafi 1 nën paragrafi 2. “vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtëndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve;.

Megjithatë, ankesat nga Subjekti Politik, Partia Kosovskih Srba (PKS), janë paraqitur pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe ankesa është dorëzuar më 07.02.2025, ndërkohë që shkeljet në fjalë janë bërë më datë 01.02.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 paragrafi 3, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Anr.418/2025 më datë 09.02.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.